

A ka njëzëshmëri (*ixhma*) se teravitë janë 20 rekate

Shejh bin Baz, Ibnul Utthejmin & Komisioni i Dijetarëve të Mëdhenj

Burimi: *el-Istikame*, botimi nr.5, ramazan 1417/janar 1997

Pyetje: Disa persona insistojnë se ka njëzëshmëri (*ixhma*) nga katër Imamët e njohur – Ebu Hanife, Malik, esh-Shafi'i dhe Ahmed (*rahimehumullah*) – mbi faljen e 20 rekateve në namazin e teravive. A është kjo e saktë?

Përgjigje: Kjo është një thënie e gabuar. Kjo është thënë në librat e fikhut (jurisprudencës) Hanefij, meqë në nuk gjejmë ndonjë libër që në të vërtetë i është atribuuar Ebu Hanifes (v.150H). Bile, mbasi këqyrim në *el-Muwetta* të Imam Muhamed (një nga studentët kryesor të Ebu Hanifes), vërejmë që medhhebi i Ebu Hanifes ishte që të falen 11 rekate.

Imam Muhamed përfshin një kaptinë në *el-Muwetta* (f.110), ku thotë: "Kaptina: Falja e namazit të natës në muajin e ramazanit dhe vlera e saj". Nën këtë kaptinë, ai transmeton katër hadithe. Transmetimi i parë, i tretë dhe i katërt nuk përmendin ndonjë numër të caktuar rekatesh për namazin e teravive. Në to, përmendet vetëm vlera e faljes me xhemat dhe vlera e namazit të natës në ramazan. Mirëpo, në transmetimin e dytë, përmenden 11 rekate. Pastaj, Imam Muhamed tha (f.111):

"Ne e pranojmë krejt këtë".

Kështu, ai tregoi se medhhebi i tij është 11 rekate, dhe ky mund të jetë vetëm medhhebi i Imam Ebu Hanifes (*rahmetullahi alejhi*), po ashtu.

Esh-Shafi'i (v.204H) (*rahimehullah*) tha:

"S'ka kufi për numrin e tyre (teravive), meqë ky është namaz i vullnetshëm. Pra, nëse zgjatet qëndrimi në këmbë (*kijami*) dhe pakësohet numri i sexhdeve (dmth i rekateve), atëherë kjo është mirë dhe kjo është me e pëlqyeshme për mua. Mirëpo, nëse numri i sexhdeve dhe rukuve shtohet (dmth shtohet numri i rekateve), atëherë edhe kjo, po ashtu, është mirë"¹.

Kështu, është vërtetuar se Imam esh-Shafi' (*rahimehullah*) nuk mbështet kufizimin e numrit të rekateve në 20. Më saktë, ai parapëlqen të falen më pak rekate dhe të zgjatet qëndrimi (*kijami*).

¹ Cituar nga Ibn Nasr el-Merwezij në *Kijamul-Lejl* (f.92).

Imam Ahmed ibn Hanbel (v.241H) i ka miratuar 11 rekate e, po ashtu, edhe 20, siç thotë Shejhul-Islam Ibn Tejmije në *el-Ikhtijaratul-Ilmije* (f.38) dhe Shah Welijjullah në *el-Misrijeh* (1/174) dhe në *el-Museffaa* (1/177).

Imam Malik (v.179H) (*rahimehullah*), gjithashtu, mbështet faljen e 11 rekateve, siç përmendi Shejhul-Islam Ibn Tejmije në *el-Ikhtijerat* (f.350) dhe siç përmend Xhelalud-Din es-Sujuti në *el-Hauij lil-Fetaua* (f.350), ku thotë:

"el-Xhurij, një nga bashkëmendimtarët tanë, transmetoi nga Malik, i cili kishte thënë: 'Ajo në çka i mblodhi njerëzit Umer ibnul-Khatab, është më e dashur për ne, dhe ajo ishte 11 rekate; ky ishte edhe namazi i të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selam)'. Iu tha: '11 rekate me gjithë witr?' Tha: 'Po. Dhe 13 është afër'. Pastaj tha: 'Nuk di nga i kanë futur këto ruku të shumta'"².

Falja e 11 rekateve bazohet në një numër transmetimesh të vërteta, ndër to:

- 1) Ajo çka transmeton el-Buhari në *Sahih* e tij nga Ebu Seleme ibn AbduRahman, i cili e pyeti Aishen (*radi Allahu anha*): "Si falej i Dërguari gjatë ramazanit?" Ajo u përgjigj: "Ai nuk falte më shumë se 11 rekate as në ramazan, as jashtë tij. Ai i falte katër dhe mos pyet sa të bukura e të gjata ishin ato. Pastaj i falte katër dhe mos pyet sa të bukura e të gjata ishin ato. Pastaj i falte tri rekate (Witr)".
- 2) Xhabir (*radi Allahu anhu*) tha: "I Dërguari i Allahut na udhëhoqi në muajin e ramazanit me 8 rekate dhe witrin. Pastaj, natën e radhës, u mblodhëm në xhami dhe shpresuam se ai do të dilte dhe vazhduam kështu (të prisnim), deri në agim. Ne u kthyem në shtëpitë tona dhe, më vonë, thamë: 'O i Dërguar i Allahut, mbrëmë u mblodhëm me shpresë se do të faleshe me ne'. Ai tha: 'U tuta se mos po ju bëhej obligim'"³.
- 3) Imam Malik transmeton në *el-Muwetta* (nr.248): "Nga Muhamed ibn Jusuf, nga es-Sa'ib ibn Jezid, i cili tha: 'Umer ibnul-Khatab urdhëroi Ubej ibn Ka'bin dhe Temim ed-Darin të udhëhiqnin njerëzit në namaz me 11 rekate. Recituesi do të recitonte nja njëqind ajete, derisa ndonjëri prej nesh do të mbështetej për shkopi, për shkak të gjatësisë së *kijamit* dhe, zakonisht, nuk e kryenim para agimit'"⁴.
- 4) Ubej bin Ka'b erdhi te i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) dhe tha: "O i Dërguar i Allahut, mbrëmë më bëri vaki diçka (dmth në ramazan). Ai tha: "Çka ndodhi, o Ubej?" Ai tha: "Disa gra të shtëpisë sime më thanë: 'Ne nuk recitojmë Kuran, kështu që a do të na udhëheqësh në namaz?' Dhe unë i udhëhoqa në tetë

² *Tenkidus-Sedid bi Risaleti Ixhtihad uet-Taklid* (f.266-268) e shejh Bediud-Din es-Sindi.

³ Transmetuar nga Ibn Nasr (f.90) dhe të tjerët. El-Hafidh ibn Haxher tregoi në *Fet'hul Barij* (3/10) se transmetimi është i fortë.

⁴ Shejh Albani thotë në *Salatut-Terauih* (f.4): "Zinxhiri i transmetimit është *Sahih Xhiddin* (shumë i sigurt)".

rekate dhe ua fala witrin". Kjo ishte një sunet me miratimin e tij, meqë ai heshti dhe nuk tha ndonjë gjë⁵.

Pra, krejt kjo tregon se insistimi se ka njëzëshmëri (*ixhma*) mbi faljen e vetëm 20 rekateve për teravi, duke pohuar se ky është qëndrimi i vetëm i katër Imamëve të njohur, s'është me vend. Bile, kjo bie në kundërshtim me dëshmitë e vërtetuara ... Diskutimet mbi saktësinë apo vlerën e faljes së 20 rekateve më parë sesa 8 dhe anasjelltas, mund të gjinden në kaptinat e rëndësishme në librat e fikhut, ndërsa kemi parasysh se: "Dallimi në mendime, s'duhet të jetë burim i kryeneçësisë dhe i hidhërimit"⁶.

⁵ Hasan: Transmetuar nga Ibn Nasr el-Merwezij (f.90). Qe vërtetuar nga Shejh Albani në *Salatut-Terauih* (f.68).

⁶ Nga *Adahul-Khilaf* (f.7) e shejh Salih el-Humeid.